



# BULETINI

Shkurt 2009

Numri 2/2009

## Permbajtja

- Tryezë diskutimesh – penale: Detyrat e përgjithshme dhe autorizimet e prokurorit publik
- Seminar - civile: Risitë kryesore në ligjin e procedurës përmbartimore
- Tryezë pune për gjyqtarët e gjykatave të kundërvajtjes: Përpilimi i kërkesës nga orani kompetent
- Trajnim i Trajnuesve—Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut—Vizitë Studimore
- Tryezë pune-civile: Procedura jashtëkontestimore-Rregullimi i mezhdës
- Seminar civile: Kontrata për ndërtime
- Tryezë diskutimesh-penale: IDispozitat e përgjegjshme lidhur me provat
- Tryezë pune-penale: Marrja në pyetje e të pandehurit
- Tryezë diskutimesh – civile: Përfitimi joproportional te Kontrata për borxhin
- Trajnimi nga Programi Fillestar Për Arsimit Ligjor

Zhvillim  
Profesional  
Gjyqësor

## Tryezë diskutimesh - penale: Detyrat e përgjithshme dhe autorizimet e prokurorit publik

Instituti Gjyqësor i Kosovës më 3 shkurt 2009 ka realizuar tryezën e diskutimeve me temë “Detyrat dhe autorizimet e prokurorit publik”. Në këtë sesion trajnues u trajtuan çështjet më të rëndësishme rreth kompetencave të prokurorit publik lidhur me dhënien e autorizimeve policisë dhe zyrtarë nga policia e Kosovës. Paraprakisht u bë një elaborim i dispozitave lidhur me



kërkesën për caktimin e paraburgimit nga ana e prokurorit publik duke përfshirë edhe të drejtën e të pandehurit në mbrojtje dhe respektimi i parimit të legalitetit për fillimin e hetimeve. Përfitues të trajnimit ishin: gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës si dhe zyrtarë nga policia e Kosovës.

## Seminar - civile: Risitë kryesore në ligjin e procedurës përmbartimore

Më datën 05 shkurt 2009 u organizua seminari në lëmin civile me temën “Risitë kryesore në Ligjin e Procedurës Përmbartimore”.

Temat kryesore që u diskutuan kishin të bënin lidhur me: Risitë e Ligjit për Procedurën Përmbartimore, dallimet në mes të dispozitave të vjetra dhe atyre të reja të LPP-së dhe me mënyrën se si t'i qasen gjykatësit zbatimit praktik të dispozitave të reja të LPP-së. Gjithashtu vëmendje e veçantë iu kushtua vështirësive me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zbatimin e dispozitave të reja ligjore mbi procedurën përmbartimore. Përfitues



të këtij seminari ishin gjyqtarët e lëmis civile të të gjitha regjioneve të Kosovës.

## Tryezë pune për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje: Përpilimi i kërkesës nga organi kompetent

Më 10 shkurt 2009, u organizua një tryezë pune për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje me temë "Përpilimi i kërkesës nga organi kompetent". Gjatë kësaj tryeze u analizua përmbajtja e kërkesës për kundërvajtje, duke filluar nga ana formale, përshkrimi i gjendjes faktike, kualifikimi juridik, mbledhja e provave si dhe rëndësia e tyre në procedurën kundërvajtëse. Vëmendje e veçantë ju kushtua



përshkrimit të gjendjes faktike dhe rëndësisë së këtij

përshkrimi për gjyqtarët të cilët do të vendosin për rastin e caktuar si dhe mbledhjes së provave, me theks të veçantë në rastet e skicimit apo fotografimit të vendit të ngjarjes. Përfitues të kësaj tryeze pune ishin: gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje dhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

## Trajnim i Trajnuesve – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Vizitë studimore

Me 11-13 shkurt 2009 Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Këshillin e Evropës ka organizuar trajnimin e trajnuesve lidhur me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me ç'rast një grup i zgjedhur i trajnuesve kanë udhëtuar për në Strasburg të Francës ku kanë ndjekur një trajnim të avancuar të trajnuesve.

## Tryezë pune - civile: Procedura jashtëkontestimore - Rregullimi i mezhdës

Më datën 11 shkurt 2009 është organizuar tryeza e punës në lëmin civil me temën "Rregullimi i mezhdës".

Temat kryesore që u diskutuan në kuadër të kësaj tryeze, kishin të bënin lidhur me: trajtimin e problematikës së rregullimit të mezhdës, hartimin e aktvendimit për rregullimin e mezhdës, formën dhe përmbajtjen e dispozitivit



të aktvendimit të tillë, etj. Gjatë këtij trajnimi u paraqitën shembuj praktik për të ilustruar rregullimin e mezhdës dhe evitimin e lëshimeve të cilat po paraqiten në punën e gjyqtarëve në këto çështje. Gjithashtu me interes të shumëfishtë ishin edhe sqarimet e bëra nga përfaqësuesi i Agjencionit Kadastral të Kosovës. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmis civile të të gjitha regjioneve të Kosovës.

## Seminar - civile: Risitë më të rëndësishme në Ligjin për Procedurën Kontestimore

Si përpjekje për të qenë në hap me zhvillimet legislative, më datën 12 shkurt 2009 është organizuar për të dytën herë me radhë seminari me temën "Risitë kryesore në Ligjin e Procedurës Kontestimore". Çështjet e trajtuara në këtë seminar kishin të bënin lidhur me: Risitë e Ligjit për Procedurën Kontestimore, dallimet në mes të dispozitave të vjetra dhe atyre të reja të



LPK-së dhe me mënyrën se si t'i qasen gjyqtarët zbatimit praktik të dispozitave të reja të LPK-së. Gjithashtu vëmendje e veçantë iu kushtua vështirësive me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zbatimin e dispozitave të reja mbi proced. kontestimore. Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarët e lëmis civile nga të gjitha regjionet e Kosovës.

### Seminar - civile: Kontrata për ndërtimin

Me datën 19 shkurt 2009, është organizuar seminari në lëmin civile me temë “Kontrata për Ndërtimin”. Nën temat të cilat u shtjelluan gjatë punës së këtij seminari u përqendruan në çështjet që kanë të bëjnë me; punët shtesë të cilat nuk janë të parapara me kontratën

themelore, aneksi i kontratës, ndërtimi sipas parimit me çelësa në dorë, projekti ndërtimor dhe leja e ndërtimit. Gjithashtu vëmendje e veçantë iu kushtua edhe vështirësive me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zbatimin e dispozitave ligjore në praktik.



Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarët e lëmisë civile të të gjitha regjioneve të Kosovës.

### Tryezë diskutimesh - penale: Dispozitat e përgjithshme lidhur me provat

Më 24 shkurt 2009, është realizuar tryeza e diskutimeve me temë “Dispozitat e përgjithshme lidhur me provat”. Temat të cilat u diskutuan gjatë kësaj tryeze diskutimesh kryesisht u përqendruan në procedurën e provave si një aktivitet i rëndësishëm i procedurës provuese, nëpërmjet të cilit gjykata mëson për faktet juridike relevante në procedurën penale. Rëndësi parësore gjatë analizimit të kësaj faze të procedurës i është kushtuar kushteve në të cilat është nxjerr një provë, kushteve ligjore të cilat i bëjnë provat të pranueshme apo të papranueshme.



### Tryezë pune - penale: Marrja në pyetje e të pandehurit



Më datë 26 shkurt 2009, është organizuar tryeza e diskutimeve me temë “Marrja në pyetje e të pandehurit”. Në këtë sesion trajnues u trajtuan çështjet rreth harmonizimit të praktikave më të

avancuara dhe eliminimin e dilemave me rastin e marrjes në pyetje të të pandehurit nga ana e policisë dhe e prokurorit publik. Trajnimit e përshkoi diskutimi interaktiv i pjesëmarrësve me qëllim të eliminimit të mangësive dhe të evitimit të problemeve të cilat shfaqen në punën praktike. Përfitues të trajnimit ishin: gjyqtarë dhe pr kurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës dhe pjestarë të Policisë së Kosovës

### Tryezë diskutimesh - civile: Përfitimi joproporcional te kontrata për borxhin

Më datën 27 shkurt 2009, është organizuar tryeza e diskutimeve në lëmin civile me temën “Përfitimi jo proporcional te kontrata për borxhin”. Temat kryesore që u trajtuan në këtë trajnim kishin të bënin lidhur me: Kontratën fiktive përkatësisht simuluese në relacion me kontratën për fajdenë, anulimin dhe mbetjen në fuqi të kontratës si dhe revidimin e kontratës faktike. Trajnuesit trajtuan dhe analizuan shembuj tipik për të ilustruar kontrata fiktive. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmis civile nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmis civile nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Trajnimet nga Programi Fillestar për Arsimim Ligjor

Të filluara me 22 shtator 2008 trajnimet në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor në fazën e parë kanë vazhduar edhe gjatë muajit shkurt sipas planprogramit, kalendarit dhe orarit trajnues të parashikuar. Trajnimet janë mbajtur tri ditë në javë në këto module: Moduli 1, Kodi Penal (pjesa e përgjithshme), Moduli 2, Kodi i Procedurës Penale (pjesa 1-2), Moduli 3, KEDNJ, Të Drejtat e Njeriut, Moduli 4, Etikë gjyqësore, Moduli 5, Kodi Penal (pjesa e posaçme), Moduli 6, Kodi i Procedurës Penale (pjesa 3-4), Moduli 7, Trafikimi me Njerëz, Moduli 8, Shkrimi, Arsyetimi dhe Hulumtimi Ligjor, Moduli 9, Kodi i Procedurës Penale (pjesa 5-8), Moduli 10, Ligji Penal për të Mitur, Moduli 11, Krimi Financiar dhe Korrupsioni, Moduli 12, E drejta Administrative dhe Kushtetuese.

Trajnimi është vijuar nga 30 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë.

Me qëllim të matjes së aftësive dhe shkathtësive të fituara nga kandidatët që ndjekin trajnimet e Programit Fillestar për Arsimim Ligjor, gjatë muajit shkurt nga ana e trajnuesve të IGJK-së është hartuar provimi final për fazën e parë të këtij programi i cili do të administrohet në muajin mars. Rregullat për hartimin, organizimin dhe administrimin e këtij provimi kanë qenë të njëjta me rregullat e zbatuara në Provimin Përgatitor/Hyrës.

Provime të tilla do të organizohen në përfundim të çdo faze të PFAL dhe rezultatet e kandidatëve do t'u dërgohen autoriteteve përgjegjëse për rekomandimin final të tyre për emërim.

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr. "Muharrem Fejza"  
p.n.  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069  
+381 (0) 38 512 081  
+381 (0) 38 512 095  
[www.kjijudicial.org](http://www.kjijudicial.org)